



Prenuar / Dorezuar Prinjehofo/Prudato Received/Delivery		28 - 09 - 2022	2 viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5734/2022		1/1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.714/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2352/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 24.08.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.714/2022 të datës 02.08.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtafatshme ankesa me numër A.nr.714/2022 e datës 02.08.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankueses, \_\_\_\_\_ e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 02.07.2021 i ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje” me arsyetimin se e njëjta ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 4 në paragrafi 4.3 dhe 4.4 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja kundër vërejtjes me numër ref:20/2021 të datës 02.07.2022, përmes e-maili ka parashtruar ankesë me datë 02.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të



Kosovës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka konstatuar drejt gjendjen faktike, arsyetimi është kundërthënës dhe se masa disiplinore si e tillë është bërë me qëllim të presionit të vazhdueshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 04.08.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 11.08.2021 ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë, ndërsa ankuesja me datë 21.09.2022 ka bërë plotësimin e ankesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesja ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 13.09.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankueses për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 24.08.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2352/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 13.09.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 02.08.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 02.08.2022 me Nr.Prot:4040/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 02.08.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Vërejtjen e datës 01.07.2022 me numër Ref:20/2021 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së; E-mailin e datës 01.07.2021 dërguar nga B.E për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; E-mailin e datës 28.06.2021 dërguar nga A.D për B.Xh me korrespondencën prej shtatë (7) faqesh; Shkresën e titulluar Annex 11 "tarifat aeronautikës"; Shkresën e titulluar Annex 11 "tarifat ndihmëse"; Plotësimin e ankesës i datës 21.09.2022; Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së e datës 18.10.2021 drejtuar Kryeministrit; Vendimin e datës 19.01.2021 e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së; Shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së e datës 17.07.2020; Shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së e datës 27.07.2020; Shkresën e datës 30.08.20219 lëshuar nga Limak Kosovo; Shkresën e datës 20.12.20219 lëshuar nga Limak Kosovo; Vendimin e datës 30.09.2019 e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së; E-mailin e datës 23.07.2020 dërguar nga K.O për N.B me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Shkresën e titulluar Annex 11 "Part B: Ancillary Fees and Charges"; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.08.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 11.08.2021; E-mailin e datës 02.07.2021 dërguar nga A.Th për B.U dhe S.S; Akt emërimin e ankueses të datës 01.01.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankueses; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 30.01.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 01.02.2021; E-mailin e datës 26.06.2021 dërguar nga B.Xh për A.D me korrespondencën e bashkangjitur prej shtatë (7) faqesh;



Njoftimin e datës 13.09.2021; Aktgjykimin A.nr.2352/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 24.08.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.714 /2021 e datës 02.08.2021, e parashtruar nga ankuesja është e *jashtafatshme*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 01.01.2012 mbanë pozitën *"Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit"* në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 02.07.2022 përmes shkresës me numër Ref:/20/2021 dhe numër protokoli:2021/ZDP/203 i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore *"vërejtje"* me arsyetimin se e njëjta arsyetimin se e njëjta ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 4 në paragrafi 4.3 dhe 4.4 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja, me rastin e parashtrimit të ankesës me datë 02.08.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës iu është referuar nenit 16 të Rregullores nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *"Çdo nëpunës civil në pajtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik mund të paraqesë ankesë në KPMSHC brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data kur pala është e njoftuar me vendimin për masën disiplinore"*,

Kolegji i Këshillit me qëllim të vlerësimit të afatshmërisë së parashtrimit të ankesës, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"* si dhe neni 127 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, ndërsa ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill përmes e-mailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka theksuar se e njëjta për masën e shqiptuar disiplinore është njoftuar me datë 02.07.2021, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshill me datë 02.08.2021 kundër vërejtjes së shqiptuar me datë 02.07.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil të Kosovës, është e palejuar pasi që e njëjta është parashtruara jashtë afatit të përcaktuar kohorë prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin apo për shqiptimin e masës disiplinore *"vërejtje"*, gjegjësisht ankesa në Këshill është parashtruar në kundërshtim me nenin 16 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë si dhe në kundërshtim edhe me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është hedhur poshtë si e jashtafatshme sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.714/2021

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Eshref SHBANI**

*Kryetar i Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

